

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT FLORIAN RAUNIG, NË FORUMIN PËR REFORMËN NË DREJTËSI

Durrës, 25 nëntor 2015

Mirëdita, zonja dhe zotërinj! Gëzohem që shoh kaq shumë studentë t'u bashkohen këtyre diskutimeve të rëndësishme për të studiuar ndryshimet kushtetuese të propozuara dhe rëndësinë e tyre për të ardhmen.

E përgëzoj Kuvendin për organizimin e këtyre takimeve, si pjesë e raundit të dytë të konsultimeve për reformën e sistemit të drejtësisë, tashmë në zhvillim e sipër në Kuvend. Shumë prej jush i kam takuar kur isha këtu në korrik për prezantimin e Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, e cila ishte produkt i fazës së parë të kësaj reforme.

Që atëherë, ne kemi vijuar punën për një reformë gjithëpërfshirëse dhe tërësore që përmbush standardet ndërkombëtare. Kur them “ne”, e kam fjalën për Kuvendin dhe Nënkomisionin e Posaçëm të tij për Reformën në Drejtësi, ekspertët dhe partnerët ndërkombëtarë, si Prezenca e OSBE-së- dhe ju, qytetarët e Shqipërisë. Kjo për shkak se reforma me siguri do t'i arrijë këto rezultate më së miri nëse paraqet vizionin e përbashkët të shqiptarëve për një sistem drejtësie të shekullit të 21-të.

Më duhet të vlerësoj këtu punën e ekspertëve dhe përkushtimin e tyre personal për pjesëmarrjen e qytetarëve në reformën në drejtësi. Për mua është nder të ndaj podiumin me këta akademikë të mirënjohur shqiptarë dhe me kolegët e tyre ndërkombëtarë. Këtë muaj, ata do të vizitojnë qytetet kryesore të Shqipërisë për të dëgjuar prej jush dhe prej disa bashkëqytetarëve tuaj.

Pse është kaq i rëndësishëm ky diskutim? Sepse është i rëndësishëm për ju. Çdo ndryshim i Kushtetutës ndikon në jetën e qytetarëve. Por tani ne po flasim për 53 ndryshime të propozuara që ndikojnë në të gjithë sistemin gjyqësor.

Këto ndryshime duhet të garantojnë themelin për një sistem drejtësie të përtërirë e që do t'i shërbejë më mirë qytetarëve shqiptarë. Ato duhet të ndiqen nga një veprimtari legislative intensive dhe nga një sërë masash për zbatim, përfshirë këtu rregullore të reja, procedura, sisteme programesh kompjuterike dhe menaxhimi, si dhe trajnim. Në këtë universitet dhe në universitete të tjera, juristët e së ardhmes do të mësojnë mënyra të reja të bërjes drejtësi.

Ky është ambienti ideal për të diskutuar në lidhje me nisjen e një kapitulli të ri në historinë kushtetuese të Shqipërisë; këtu, mes profesionistëve të rinj që po nisin karrierën e tyre si ekspertë ligjorë. Unë shpresoj vërtet se ndryshimet legislative do të sjellin drejtësi më të mirë. Por, në fund të fundit, kjo është në duart tuaja.

Si juristë, ju do t'i ndiqni ndryshimet ligjore me interes të madh profesional. Gjithashtu, ju duhet të merrni pjesë aktivisht në vënien në zbatim të masave praktike e sistematike për administrimin e drejtësisë, masa me rëndësi thelbësore për efikasitetin dhe integritetin gjyqësor. Përfundimi i reformës në drejtësi nuk mund të arrihet në Kuvend; ai duhet të arrihet në gjykatat e çdo rrethi të vendit, me radhë nga Tropoja deri në Sarandë.

Kjo është ideja që qëndron pas partneritetit të Prezencës së OSBE-së me kryetarët e gjykatave, gjyqtarët dhe subjektet që u drejtohen gjykatave për të vënë në zbatim sistemin aktiv të menaxhimit të çështjeve, partneritetet që ka rezultuar shumë i suksesshëm në pakësimin e vonesave në gjykime në Krujë dhe Korçë, duke sjellë *Drejtësi pa Vonesa*. Vënia në zbatim e administrimit modern dhe transparent do të kërkojë angazhimin e plotë të juristëve të brezit tuaj.

Kur isha këtu në korrik, u shpreha se:

Konsultimi nuk është vetëm punë e qeverisë ose e Parlamentit. Edhe pse është detyrë e autoriteteve publike t'i hapin derën pjesëmarrjes së qytetarëve, është po aq edhe detyrë e juaja, dhe e jona, të trokasim në atë derë.

Epo, ajo derë tashmë është hapur. Nëse keni vullnetin, ajo mund të çojë në një shtet më të mirë të së drejtës, në përputhje me Kushtetutën, në qeverisje gjyqësore që respekton standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-së. Kjo është dera e së ardhmes suaj.